



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:261831

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05438953

P.nr.1286/22

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN– Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari Lulzim Hoxha, me bashkëpunëtoren profesionale Afërdita Kicaj, në çështjen penale ndaj të pandehurve: R.Q., nga Prizreni, E.Q., nga Prizreni, E.H., nga Prizreni dhe D.K., nga Prizreni, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 184 para.1 dhe para.2 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr.1937-1/22, të datës 09.12.2022, në bazë të nenit 357 par.1 nënpar.1.3.të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së) dhe nenit 12 par.12.5.të Ligjit mbi Ndërmjetësimin, jashtë seancës, më datë 11.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim, e lidhur në mes të pandehurve: R.Q., nga Prizreni, E.Q., nga Prizreni, E.H., nga Prizreni dhe De.K., nga Prizreni në Prizren, në Zyrën e Ndërmjetësimit në Prizren, me datë **21.02.2024**.

II. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr.1937-1/22, të datës 09.12.2022, dhe **PUSHOHET** procedura penale kundër të pandehurve: R.Q., nga Prizreni, E.Q., nga Prizreni, E.H., nga Prizreni dhe D.K., nga Prizreni, **për shkak se të pandehurit kanë arritur marrëveshjen për ndërmjetësim**.

III. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore te kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP/II.nr.1937-1/22, të datës 09.12.2022, i ka akuzuar të pandehurit R.Q., nga Prizreni, E.Q., nga Prizreni, E.H., nga Prizreni dhe D.K., nga Prizreni, për shkak se kanë kryer veprën penale, sulmi nga neni 184 para.1 dhe para.2 të KPRK-së.

Kjo gjykatë, ka filluar seancën e shqyrtimit fillestar, në çështjen penale ndaj të pandehurve R.Q., nga Prizreni, E.Q., nga Prizreni, E.H., nga Prizreni dhe D.K., nga Prizreni, për shkak se ka kryer veprën penale, sulmi nga neni 184 para.1 dhe para.2 të KPRK-së, dhe në fillim të seancës e cila është mbajtur me datë 21.02.2024, të pandehurit kanë propozuar që kjo çështje penale të zgjidhet në procedurën e ndërmjetësimit, të cilin propozim nuk e ka

kundërshtuar Prokurori i Shtetit, ashtu që edhe gjyqtari e ka ndërprerë seancën dhe i ka udhëzuar palët se këtë çështje mund ta zgjidhin edhe me ndërmjetësim.

Me datë 21.02.2024, në Zyrën e Ndërmjetësimit në Prizren, është lidhur marrëveshja për zgjidhjen e ndërmjetësuar ndërmjet të pandehurve R.Q., nga Prizreni, E.Q., nga Prizreni, E.H., nga Prizreni dhe D.K., nga Prizreni, të pandehurit janë penduar thellë për veprimet e bëra dhe premtojnë se nuk do të përsërisin veprime të tilla kundërligjore.

Palët pa ndonjë kërcënim dhe me vet dëshirë kanë shprehur gatishmërinë që kjo çështje të zgjidhet me marrëveshje për zgjidhjen e ndërmjetësuar dhe nuk e kontestojnë asnjë nga pikat e lartpërmendura.

Zyra për Ndërmjetësim me datë 21.02.2024, me nr. ref. të ndërmjetësimit Ndm.66/24, ka lidhur marrëveshjen e palëve për zgjidhjen e ndërmjetësuar.

Gjykata duke u bazuar në provat si më lartë dhe në bazë të nenit 357 par.1 nën paragrafi 1.3.të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së), dhe nenit 12, par.12.5 të Ligjit mbi Ndërmjetësim, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.1286/22, datës 11.03.2023

Bashkëpunëtore Profesionale
Afërdita Kicaj

Gjyqtari
Lulzim Hoxha

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa.
Kjo marrëveshje e ka fuqinë e titullit ekzekutiv.